



Distributor i kufizuar. Plotësoni Pjesën XI. Llogari që nuk është llogari financiare.

**6** Adresa e banimit të përhershëm (rrugë, nr. i apartamenti ose suitës, ose rrugë rurale). **Mos përdorni adresën e kutisë postare ose adresën e dikujt tjetër – adresë ndërmjetësuese.** (përveç adresës së regjistruar).

Qyteti ose qyteza, shteti ose rajoni. Përfshini kodin postar kur është e përshtatshme.	Vendi
--	-------

**7** Adresa e postës (nëse është e ndryshme nga lart)

Qyteti ose qyteza, shteti ose rajoni. Përfshini kodin postar kur është e përshtatshme.	Vendi
--	-------

<b>8</b> Numri i Identifikimit të Tatimpaguesit (NIT) të SHBA, nëse kërkohet	<b>9a</b> GJIN	<b>b</b> NIT i huaj
--	----------------	---------------------

**10** Numri(-at) i referencës (shiko udhëzimet)

**Shënim:** Ju lutemi plotësoni pjesën e mbetur të formularit, përfshirë nënshkrimin e formularit në Pjesën XXX.

**Për Njoftimin për Aktin e Reduktimit të Dokumenteve, shih udhëzime të ndara.** Nr. Kat. 59689N

Formulari **W-8BEN-E** (Rish. 7-2017)

**Pjesa II Entiteti i ndarë ose Dega që Pranon Pagesa.** (Plotësoni vetëm nëse entiteti i ndarë me GJIN ose degë të IHF në vend tjetër nga vendi i themelimit të IHF. Shihni udhëzimet.)

- 11 Statusi i Kapitullit 4 (statusi FATCA) i entitetit të pavarur ose degës që pranon pagesa
- Dega e trajtuar si IHF jo pjesëmarrës.  IHF raportues sipas modelit 1.  Degë e SHBA.
- IHF pjesëmarrës.  IHF raportues sipas modelit 2.
- 12 Adresa e entitetit të pavarur ose degës (rrugë, nr. i apartamentit, ose rrugë rurale). **Mos përdorni adresën e kutisë postare ose adresën e dikujt tjetër – adresë ndërmjetësuere.** (përveç adresës së regjistruar).

Qyteti ose qyteza, shteti ose rajoni. Përfshini kodin postar kur është e përshtatshme..

Vendi

- 13 GJIN (nëse ka)

**Pjesa III Kërkesa për përfitim nga marrëveshja tatimore** (nëse aplikohet). (Vetëm për qëllime të kapitullit 3.)

- 14 Vërtetohet që (përzgjidhni të gjitha ato që aplikohen):
- a  Pronari përfitues është banor i \_\_\_\_\_ brenda kuptimit të marrëveshjes së tatimeve në të ardhura midis Shteteve të Bashkuara dhe atij vendi.
- b  Pronari përfitues krijon të ardhura për të cilat pretendohen përfitimet nga marrëveshja, dhe, nëse është e aplikueshme, plotëson dispozitat e marrëveshjes që kanë të bëjnë me kufizimin e përfitimeve. Më poshtë janë llojet e kufizimit të dispozitave të përfitimeve që mund të përfshihen në një marrëveshje tatimore të zbatueshme (përzgjidhni vetëm një; shiko udhëzimet):
- Qeveria  Kompania që përmbush testin e erozionit bazë dhe të pronësisë
- Fondi ose trusti pensional i përj. nga tatimi  Kompania që përmbush testin e përfitimeve derivuese
- Organizatë tjetër e përjashtuar nga tatimi  Kompania me të ardhura që përmbush testin aktiv të tregtisë ose biznesit
- Korporatë e tregtueshme publikisht  Marrja e vendimit të favorshëm diskrecional nga autoriteti kompetent amerikan
- Filial i korporatës së tregtueshme publikisht  Tjera (specifiko nenin dhe paragrafin): \_\_\_\_\_
- c  Pronari përfitues kërkon përfitime nga marrëveshja për dividendët burimore të SHBA të marrë nga një korporatë ose interes i huaj nga tregu amerikan ose biznesi i një korporate të huaj dhe plotëson statusin rezident të kualifikuar (shiko udhëzimet).
- 15 **Normat dhe kushtet speciale** (nëse është e aplikueshme — shiko udhëzimet):  
Pronari i përfitues pretendon dispozitat e nenit dhe paragrafit \_\_\_\_\_ të marrëveshjes të identifikuar në rreshtin 14a më lart për të pretenduar \_\_\_\_\_ % normën e mbajtjes në \_\_\_\_\_ burim (specifiko llojin e të hyrave): \_\_\_\_\_ Shpjegoni kushtet shtesë në nenin që pronari përfitues i plotëson që të kualifikohet për normën e mbajtjes në burim: \_\_\_\_\_

**Pjesa IV IHF i sponsorizuar**

- 16 Emri i entitetit sponsorizues: \_\_\_\_\_
- 17 **Përzgjidhni cilëndo kuti që aplikohet.**
- Vërtetohet se entiteti i identifikuar në Pjesën I:
- Është entitet investues;
  - Nuk është një QI, WP (përveç në masën që lejohet në marrëveshjen e partneritetit të huaj të tatimit të mbajtjes në burim), ose WT dhe
  - Është dakorduar me entitetin e identifikuar më lart (që nuk është IHF jo pjesëmarrës) të veprojë si subjekt sponsorizues për këtë entitet.
- Vërtetohet se entiteti i identifikuar në Pjesën I:
- Është korporatë e huaj e kontrolluar siç përcaktohet në seksionin 957(a);
  - Nuk është QI, WP, ose WT;
  - Është në pronësi të plotë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga institucioni financiar amerikan i identifikuar më lart që pajtohet të veprojë si entitet sponsorizues për këtë subjekt; **dhe**
  - Ndan një sistem të zakonshëm elektronik të llogarisë me entitetin sponsorizues (të identifikuar më lart) që i mundëson subjektit sponsorizues t'i identifikojë të gjithë mbajtësit e llogarive dhe kreditorët e entitetit dhe të ketë qasje në informacionin për llogaritë dhe klientin të ruajtur nga subjekti duke përfshirë, por jo kufizuar në, informacionin e identifikimit të klientit, dokumentacionin e klientit, gjendjen e llogarisë dhe të gjitha pagesat e bëra për mbajtësit e llogarive ose kreditorët.

**Pjesa V Banka lokale jo e regjistruar e certifikuar që konsiderohet se i përmbushë kërkesat**18  Vërtetoj që IHF i identifikuar në Pjesën I:

- Operon dhe është i licencuar ekskluzivisht si bankë ose union kreditor (ose një organizatë e ngjashme kreditore kooperative që operon pa fitim) në vendin e tij të themelimit si subjekt juridik ose organizatë;
- Është i angazhuar kryesisht në biznesin e pranimi të depozitave dhe dhënien huave të klientëve me pakicë, në lidhje me një bankë, të cilët klientë me pakicë nuk janë të lidhur me një bankë të tillë dhe, në lidhje me unionin kreditor ose një organizatë të ngjashme kreditore kooperative, anëtarë, me kusht që asnjë anëtar të mos ketë interes më të lartë se 5% në një union kreditor ose organizatë kreditore kooperative;
- Nuk i obligon mbajtësit e llogarive jashtë vendit të tij të organizatës;
- Nuk ka vend fiks të biznesit jashtë këtij vendi (për këtë qëllim, një vend i caktuar i biznesit nuk përfshin një vendndodhje që nuk reklamohet për publikun dhe nga i cili IHF kryen vetëm funksione mbështetëse administrative);
- Nuk ka më shumë se 175 milion dollarë asete në bilancin e tij të gjendjes dhe, nëse është anëtar i një grup shumëkombësh, grupi nuk ka më shumë se 500 milion dollarë në gjithsej asetet në bilancet e tij të konsoliduara ose të kombinuara të gjendjes; **dhe**
- Nuk ka ndonjë anëtar të grupit të tij të zgjeruar ndërlidhur që është një institucion financiar i huaj, përveç një institucioni të huaj financiar që është i themeluar si subjekt juridik ose organizatë në të njëjtin vend me IHF të identifikuar në Pjesën I dhe që plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë pjesë.

**Pjesa VI IHF i certifikuar që konsiderohet se i përmbushë kërkesat, me vetëm llogari me vlerë të ulët**19  Vërtetoj që IHF i identifikuar në Pjesën I:

- Nuk angazhohet kryesisht në biznesin e investimit, ri-investimit, ose tregimit të letrave me vlerë, interesave të partneritetit, mallrave, kontratave kryesore nacionale, sigurimeve ose kontratave të anuiteteve, ose ndonjë interes (përfshirë një kontratë në proces apo në të ardhmen ose në opsion) në letra me vlerë, interes partneriteti, mall, kontratë kryesore nacionale, kontratë e sigurimeve ose kontratë anuiteti të tillë;
- Asnjë llogari financiare e mbajtur nga IHF ose ndonjë anëtar i grupit të saj të zgjeruar të ndërlidhur nëse ka, nuk ka një bilanc ose vlerë më të madhe se 50,000 dollarë (siç përcaktohet pas zbatimit të rregullave të zbatueshme të agregimit të llogarisë); **dhe**
- As IHF e as i gjithë grupi i zgjeruar i ndërlidhur, nëse ekziston, i IHF-së, nuk kanë më shumë se 50 milion dollarë në asete në bilancin e tij të konsoliduar ose të kombinuar të gjendjes në fund të vitit të tij më të fundit të kontabilitetit.

**Pjesa VII Mjet i mbajtur për investime, i sponsorizuar, i certifikuar dhe që konsiderohet se i përmbushë kërkesat**

20 Emri i subjektit sponsorizues:

21  Vërtetoj që entiteti i identifikuar në Pjesën I:

- Është një IHF ekskluziv sepse është një entitet investimesh i përshkruar në seksionin e rregullave 1.1471-5 (e) (4);
- Nuk është një QI, WP, ose WT;
- Entiteti sponsorizues i identifikuar në rreshtin 20 do t'i përmbush të gjitha përgjegjësitë e tij për kujdes të duhur, mbajtjes së tatimit në burim, raportim të përgjegjësive (të përcaktuara sikur IHF të ishte një IHF pjesëmarrës); **dhe**
- 20 ose më pak individë zotërojnë të gjithë interesin e borxhit dhe ekuitetit në subjekt (duke mos marrë parasysh interesat e borxhit në pronësi të institucioneve financiare amerikane, IHF-të pjesëmarrës, IHF-të e regjistruar që konsiderohen që i përmbushin kërkesat dhe interesat e ekuitetit të zotëruar nga një subjekt nëse ai subjekt zotëron 100% të interesave të ekuitetit në IHF dhe është vetë një IHF i sponsorizuar).

**Pjesa VIII Entitet i investimit të borxhit me afat të kufizuar, i certifikuar dhe që konsiderohet se i përmbushë kërkesat**22  Vërtetoj që entiteti i identifikuar në Pjesën I:

- Ka ekzistuar që nga data 17 janar 2013;
- Ka emetuar të gjitha klasat e interesit të borxhit ose ekuitetit për investitorët në ose përpara datës 17 janar 2013, në bazë të një marrëveshje trusti ose një marrëveshje të ngjashme; dhe
- Është i certifikuar dhe konsiderohet se i përmbushë kërkesat sepse i plotëson kërkesat për t'u trajtuar si një subjekt i kufizuar i investimeve të borxhit jetësor (siç janë kufizimet në lidhje me asetet e tij dhe kërkesat e tjera sipas seksionit 1.1471-5 (f) (2) (iv)) të Rregullores.

**Pjesa IX Disa entitete të investimeve që nuk mirëmbajnë llogari financiare**23  Vërtetoj që entiteti i identifikuar në Pjesën I:

- Është një institucion financiar ekskluziv sepse është një entitet investimesh i përshkruar në seksionin 1.1471-5 (e) (4) (i) (A) e Rregullores, dhe
- Nuk mban llogari financiare.

**Pjesa X IHF i dokumentuar nga Pronari**

**Shënim:** Ky status zbatohet vetëm nëse institucioni financiar amerikan, IHF pjesëmarrës, ose IHF raportues sipas Modelit 1, të cilit i është dhënë ky formular, është pajtuar që do ta trajtojë IHF si një IHF të dokumentuar nga pronari (shiko udhëzimet për kërkesat e pranueshmërisë). Për më tepër, IHF duhet t'i bëjë vërtetimet e mëposhtme.

24a  (Të gjitha IHF-të e dokumentuara nga pronari duhet ta përzgjedhin këtë kuti) Vërtetoj që IHF i identifikuar në Pjesën I:

- Nuk vepron si ndërmjetës;
- Nuk pranon depozita në kursin e zakonshëm të një biznesi bankar ose të ngjashëm;
- Nuk mban, si një pjesë përmbajtësore të biznesit të tij, asete financiare për llogari të të tjerëve;
- Nuk është një kompani e sigurimeve (ose kompani holding e një kompanie të sigurimeve) që emeton ose është e detyruar të bëjë pagesa në lidhje me një llogari financiare;
- Nuk është në pronësi të entiteti ose pjesë e një grupi të zgjeruar të ndërlidhur me subjektin që pranon depozita në kursin e zakonshëm të një biznesi bankar ose biznes të ngjashëm, apo që mban, si një pjesë përmbajtësore e biznesit të tij, asete financiare për llogari të të tjerëve, ose është një kompani e sigurimeve (ose kompani holding e një kompanie të sigurimeve) që emeton ose është e detyruar të bëjë pagesa në lidhje me një llogari financiare;
- Nuk mban një llogari financiare për ndonjë IHF jo- pjesëmarrës; dhe
- Nuk ka ndonjë person të specifikuar në SHBA që zotërojnë një interes të ekuitetit ose interes të borxhit (përveç një interesi të borxhit që nuk është një llogari financiare ose që ka një bilanc ose vlerë që nuk kalon 50,000 dollarë) në IHF, përveç atyre që identifikohen në deklaratën raportuese të pronarit të IHF-së.

**Pjesa X IHF i dokumentuar nga Pronari (vazhdim)****Përzgjidh kutinë 24b ose 24c, cilado që është e aplikueshme.**

- b  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I:
- Ka siguruar ose do të sigurojë një deklaratë raportuese të pronarit të IHF që përmban:
    - (i) Emrin, adresën, NIT (nëse ka), statusin e kapitullit 4 dhe llojin e dokumentacionit të siguruar (nëse kërkohet) të çdo individi dhe personi të specifikuar amerikan që zotëron një interes të drejtpërdrejtë ose të tërthorët të kapitalit në IHF të dokumentuar nga pronari (duke kërkuar përmes të gjitha subjekteve përveç personat e specifikuar amerikan)
    - (ii) Emrin, adresën, NIT (nëse ka) dhe statusin e kapitullit 4 të secilit person dhe person të specifikuar amerikan që zotërojnë një interes borxhi në IHF-të e dokumentuara nga pronari (përfshirë çdo interes të tërthorët të borxhit, i cili përfshin interesat e borxhit në çdo subjekt që zotëron përfituesin drejtpërsëdrejti ose tërthorazi kreditorin ose ndonjë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthorët të ekuitetit në një debitor të kreditorit ) që përbën një llogari financiare më të madhe se \$ 50,000 (duke mos marrë parasysh të gjitha interesat e tillë të borxhit në pronësi të IHF-ve pjesëmarrëse, IHF-ve të konsideruara si të regjistruara në mënyrë të rregullt, IHF-ve të konsideruara si të certifikuar në mënyrë të rregullt, EHJF të përjashtuara, pronarët përfitues të liruar, ose persona në SHBA, të ndryshme nga personat të specifikuar në SHBA); dhe
    - (iii) Çdo informacion shtesë që kërkon agjent i mbajtjes së tatimit në burim për të përbushur detyrimet e tij në lidhje me entitetin.
  - Ka siguruar, ose do të sigurojë, dokumentacion të vlefshëm që plotëson kërkesat e pjesës 1.1471-3 (d) (6) (iii) të rregullave për secilin person të identifikuar në deklaratën raportuese të pronarit të IHF-së.
- c  Vërtetohet që IHF i identifikuar në Pjesën I ka siguruar ose do të sigurojë një shkresë të auditorit, të nënshkruar brenda 4 viteve nga data e pagesës, nga një firmë e pavarur e kontabilitetit ose një përfaqësues ligjor me vendndodhje në Shtetet e Bashkuara duke deklaruar se kompania ose përfaqësuesi ka rishikuar dokumentacionin e IHF-së në lidhje me të gjithë pronarët e tij dhe debitorët të identifikuar në pjesën 1.1471-3 (d) (6) (iv) (A) (2) e Rregulloreve dhe se IHF-ja plotëson të gjitha kërkesat që duhet për të qenë një IHF i dokumentuar nga pronari. IHF i identifikuar në Pjesën I ka siguruar gjithashtu, ose do të sigurojë, një deklaratë raportuese të pronarit të pronarëve të tij, të cilët janë persona të specifikuar në SHBA dhe Formularin (-të) W-9, me heqjet dorë në fuqi.

**Përzgjidhni kutinë 24d nëse është e aplikueshme (opsionale, shihni udhëzimet).**

- d  vërtetohet që entiteti i identifikuar në rreshtin 1 është trust që nuk ka përfitues dytësor ose klasa të përcaktuara me përfitues të pidentifikuar.

**Pjesa XI Distributori i kufizuar**

25a  (Të gjithë shpërndarësit e kufizuar duhet ta përzgjedhin këtë kuti) Vërtetohet se entiteti i identifikuar në Pjesën I:

- Operon si shpërndarës në lidhje me borxhet ose interesat e ekuitetit të fondit të kufizuar në lidhje me të cilin është ofruar ky formular;
- lu ofron shërbime investimesh të paktën 30 klientëve që nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin dhe më pak se gjysma e klientëve të saj kanë lidhje me njëri-tjetrin;
- Kërkohet të kryejë procedurat e kujdesit të duhur kundër pastrimit të parasë sipas ligjeve kundër pastrimit të parave të vendit të organizatës së tij (i cili është një juridiksion në përputhje me TFVF);
- Operon ekskluzivisht në vendin e tij të themelimit si entitet juridik ose organizimit, nuk ka vend fiks biznesi jashtë këtij vendi, dhe ka të njëjtin vend të themelimit si subjekt juridik ose organizimit si të gjithë anëtarët e grupit shumëkombësh nëse ka;
- Nuk i detyron klientë jashtë vendit të saj të themelimit si entitet juridik ose organizimit;
- Nuk ka nën administrim asete më shumë se 175 milion dollarë në gjithsej dhe nuk ka më shumë se 7 milion dollarë të hyra bruto në pasqyrën e të ardhurave të tij për vitin e fundit kontabël;
- Nuk është anëtar i grupit të zgjeruar të ndërlidhur që ka më shumë se 500 milion dollarë në gjithsej asetet nën menaxhim ose më shumë se 20 milion dollarë të hyra bruto për vitin e tij më të fundit kontabël në një pasqyrë të kombinuar ose të konsoliduar të të ardhurave; dhe
  - Nuk shpërndan ndonjë borxh ose letra me vlerë të fondit të kufizuar për personat e specifikuar në SHBA, EHJF pasiv me një ose më shumë pronarë përbajtësorë në SHBA, ose IHF jo-pjesëmarrës.

**Përzgjidh kutinë 25b ose 25c, cilado që është e aplikueshme.**

Më tej vërtetohet se në lidhje me të gjitha shitjet e borxheve ose interesave të ekuitetit në fondin e kufizuar në lidhje me të cilin është ofruar ky formular që janë bërë pas datës 31 dhjetor 2011, subjekti i identifikuar në Pjesën I:

- b  ka qenë i obliguar me një marrëveshje shpërndarjeje që përmbante një ndalim të përgjithshëm për shitjen e borxhit ose letrave me vlerë subjekteve amerikane dhe individëve rezidentë amerikanë dhe aktualisht obligohet nga një marrëveshje shpërndarjeje që përmban një ndalim të shitjes së borxhit ose letrave me vlerë në cilindo person të specifikuar në SHBA, EHJF pasiv me një ose më shumë pronarë përbajtësorë të SHBA-ve, ose IHF jo-pjesëmarrës.
- c  Aktualisht obligohet me një marrëveshje shpërndarjeje që përmban një ndalim për shitjen e borxhit ose letrave me vlerë për çdo person të specifikuar amerikan, EHJF pasiv me një ose më shumë pronarë përbajtësorë të SHBA-ve, ose IHF jo-pjesëmarrës dhe, për të gjitha shitjet e bëra para kohës që një kufizim i tillë ishte përfshirë në marrëveshjen e saj të shpërndarjes, ka rishikuar të gjitha llogaritë që lidhen me shitjet e tilla në përputhje me procedurat e identifikuar në seksionin 1.1471-4 (c) e rregulloreve të zbatueshme në llogari para ekzistuese dhe ka rikthyer ose riprovuar ndonjë, ose ka bërë që fondi i kufizuar t'i transferoj letrat me vlerë te një shpërndarës që është një IHF pjesëmarrës apo letrat me vlerë të IHF-së raportues sipas Modelit 1, të cilat u janë shitur personave të specifikuar në SHBA, EHJF pasiv me një ose më shumë pronarë përbajtësorë të SHBA-së, ose IHF jo-pjesëmarrës.

**Pjesa XII IHF i MNQ jo-raportues**

- 26  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I:
- Përbush kërkesat për t'u konsideruar institucion financiar jo-raportues në përputhje me një MNQ të zbatueshme mes Shteteve të Bashkuara dhe \_\_\_\_\_ . MNQ e zbatueshme është  Modeli 1 MNQ ose  Modeli 2 MNQ; dhe trajtohet si \_\_\_\_\_ sipas dispozitave të MNQ-së së zbatueshme ose Rregullores të Thesarit (nëse zbatohet, shih udhëzimet);
  - Nëse jeni një administrator i besuar i dokumentuar i trustit ose një subjekt i sponsorizuar, jepni emrin e administratorit të besuar ose sponsorit. Administrator i besuar është:  SHBA  I huaj

**Pjesa XIII Qeveri e huaj, qeveri e një zotërimi (territori) të SHBA-së ose Banka Qendrore e Jashtme për emetim**

- 27  Vërtetohet që subjekti i identifikuar në Pjesën I është pronari përfutues i pagesës dhe nuk është i angazhuar në aktivitete financiare tregtare të një lloji të angazhuar nga një kompani e sigurimeve, institucion kujdestar, ose institucion depozitues në lidhje me pagesat, llogaritë, ose detyrimet për të cilat paraqitet ky formular (përveç siç lejohet në pjesën 1.1471-6(h)(2) të Rregullores).

**Pjesa XIV Organizatë ndërkombëtare**

Përzgjidhni kutinë 28a ose 28b, cilado që aplikohet.

- 28a  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I është organizatë ndërkombëtare e përshkruar në pjesën 7701(a)(18).
- b  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I:
- Përbëhet kryesisht nga qeveri të huaja;
  - Njihet si organizatë ndërqeveritare ose mbi-kombëtare sipas një ligji të huaj, të ngjashëm me Ligjin për Imunitet të Organizatave Ndërkombëtare ose që ka në fuqi një marrëveshje selie me një qeveri të huaj;
  - Përfitimi i të ardhurave të subjektit nuk zbatohet për asnjë person privat; **dhe**
  - Është pronari përfutues i pagesës dhe nuk është i angazhuar në aktivitete tregtare financiare të një lloji të angazhuar nga një kompani e sigurimeve, institucion kujdestar, ose institucion depozitues në lidhje me pagesat, llogaritë ose detyrimet për të cilat paraqitet ky formular (përveç siç lejohet në pjesën 1.1471-6(h)(2) të Rregullores).

**Pjesa XV Planet e pensione të liruara**

Përzgjidhni kutinë 29a, b, c, d, e, ose f, cilado që aplikohet.

- 29a  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I:
- Është themeluar në një vend me të cilin Shtetet e Bashkuara kanë një marrëveshje për tatimin në të ardhura në fuqi (shih Pjesën III nëse merren përfitime nga marrëveshja);
  - Operohet kryesisht për të administruar ose siguruar pensione ose përfitime pensionale; **dhe**
  - Ka të drejtë në përfitimet nga marrëveshja në të ardhurat të cilat rrjedhin në fond nga burimet e SHBA-së (ose do të kishte të drejtë në përfitime nëse do të nxirte ndonjë të ardhur të tillë) si rezident i vendit tjetër i cili plotëson çdo kufizim të zbatueshëm për kërkesat e përfitimeve.
- b  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I:
- Është organizuar për sigurimin e përfitimeve të pensionit, aftësisë së kufizuar ose pas vdekjes (ose ndonjë kombinim i tyre) për përfituesit që janë ish-punonjës të një ose më shumë punëdhënësve në konsideratë për shërbimet e bëra;
  - Asnjë përfitues i vetëm nuk ka të drejtë në më shumë se 5% të aseteve të IHF;
  - I nënshtrohet rregullores së qeverisë dhe siguron raportim vjetor të informacionit për përfituesit e tij pranë autoriteteve përkatëse tatimore në vendin në të cilin fondi është themeluar ose operon; **dhe**
    - Në përgjithësi përjashtohet nga tatimi mbi të ardhurat nga investimet sipas ligjeve të vendit në të cilin është themeluar ose operon për shkak të statusit të tij si plan pensionimi;
    - Pranon të paktën 50% të kontributeve të tij të përgjithshme nga punëdhënësit sponsorizues (duke mos marrë parasysh transferimet e aseteve nga plane të tjera të përshkruara në këtë pjesë, llogaritë e pensionit të përshkruara në një Model 1 ose Model 2 të MNQ në fuqi, fonde të tjera të pensionit të përshkruara në një Model 1 ose Model 2 të MNQ në fuqi, ose llogaritë e përshkruara në pjesën 1.1471-5(b)(2)(i)(A)) të Rregullores;
    - Nuk lejon ose penalizon shpërndarjet ose tërheqjet e bëra para ndodhjes së ngjarjeve të specifikuar në lidhje me pensionin, aftësinë e kufizuar ose vdekjen (përveç shpërndarjeve të kthimit në llogari të përshkruara në pjesën 1.1471-5(b)(2)(i)(A) të Rregullores (duke iu referuar llogarive të pensionit), në llogaritë e pensionit të përshkruara në një Model 1 ose Model 2 të MNQ-së në fuqi, ose në fondet e tjera të pensionit të përshkruara në këtë pjesë ose në një Model 1 ose Model 2 të MNQ në fuqi); **ose**
    - Kufizon kontributet nga punonjësit në fond duke iu referuar të ardhurave të fituara të punonjësit ose mund të mos tejkalojë \$50,000 në vit.
- c  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I:
- Është organizuar për sigurimin e përfitimeve të pensionit, aftësisë së kufizuar ose pas vdekjes (ose ndonjë kombinim i tyre) për përfituesit që janë ish-punonjës të një ose më shumë punëdhënësve në konsideratë për shërbimet e bëra;
  - Ka më pak se 50 pjesëmarrës;
  - Sponsorizohet nga një ose më shumë punëdhënës, secili prej të cilëve nuk është subjekt investimesh ose EHJF pasiv;
  - Kontributet e punonjësve dhe të punëdhënësve në fond (duke mos marrë parasysh transferimet e aseteve nga planet e tjera të përshkruara në këtë pjesë, llogaritë e pensionit të përshkruara në një Model 1 ose Model 2 të MNQ në fuqi, ose llogaritë e përshkruara në pjesën 1.1471-5(b)(2)(i)(A) të Rregullores) janë të kufizuara duke iu referuar të ardhurave të fituara dhe kompensimit të punonjësit, përkatësisht;

- Pjesëmarrësit që nuk janë rezidentë të vendit në të cilin fondi është themeluar ose operuar nuk kanë të drejtë në më shumë se 20% të aseteve të fondit; dhe
- I nënshtrohet rregullores së qeverisë dhe siguron raportim vjetor të informacionit mbi përfituesit e tij pranë autoriteteve përkatëse tatimore në vendin në të cilin është themeluar ose operon fondi.

**Pjesa XV Planet e pensioneve të liruara (vazhdon)**

- d  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I është formuar në bazë të një plani pensioni që do të plotësonte kërkesat e pjesës 401(a), e ndryshme nga ajo që plani të financohet nga një trust i krijuar ose i organizuar në Shtetet e Bashkuara.
- e  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I është krijuar ekskluzivisht për të fituar të ardhura për përfitimin e një ose më shumë fondeve të pensionit të përshkruara në këtë pjesë ose në një Model 1 ose Model 2 të MNQ në fuqi, ose llogari të përshkruara në pjesën 1.1471-5(b)(2)(i)(A) të Rregullores (duke iu referuar llogarive të pensionit), ose llogari të pensionit të përshkruara në një Model 1 ose Model 2 të MNQ në fuqi.
- f  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I:
- Është themeluar dhe sponsorizohet nga një qeveri e huaj, organizatë ndërkombëtare, një bankë qendrore e emetimit, ose një qeveri e një zotërimi (territori) të SHBA-së (secila siç përcaktohet në pjesën 1.1471-6 të Rregullores) ose një pronar përfitues i liruuar i përshkruar në një Model 1 ose Model 2 të MNQ në fuqi për të siguruar përfitime pensioni, të aftësisë së kufizuar ose pas vdekjes për përfituesit ose pjesëmarrësit që janë punonjës aktualë ose të mëparshëm të sponsorit (ose personave të caktuar nga punonjësit e tillë); **ose**
  - Është themeluar dhe sponsorizohet nga një qeveri e huaj, organizatë ndërkombëtare, një bankë qendrore e emetimit, ose një qeveri e një zotërimi (territori) të SHBA-së (secila siç përcaktohet në pjesën 1.1471-6 të Rregullores) ose një pronar përfitues i liruuar i përshkruar në një Model 1 ose Model 2 të MNQ në fuqi për të siguruar përfitime pensioni, të aftësisë së kufizuar ose pas vdekjes për përfituesit ose pjesëmarrësit që nuk janë punonjës aktualë ose të mëparshëm të sponsorit, por janë në konsideratë të shërbimeve personale të kryera për sponsorin.

**Pjesa XVI Subjekt i zotëruar tërësisht nga pronarët përfitues të liruuar**

- 30  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I:
- Është IHF vetëm për shkak se është entitet investues;
  - Çdo mbajtës i drejtpërdrejtë i interesave të kapitalit në subjektin investues është pronar përfitues i liruuar i përshkruar në pjesën 1.1471-6 të Rregullores ose në një Model 1 ose Model 2 të MNQ në fuqi;
  - Çdo mbajtës i drejtpërdrejtë i interesave të borxhit në entitetin investues është ose një institucion depozitues (në lidhje me kredinë që i është bërë një subjekti të tillë) ose pronar përfitues i liruuar i përshkruar në pjesën 1.1471-6 të Rregullores ose në një Model 1 ose Model 2 të MNQ në fuqi.
  - Ka siguruar një deklaratë raportuese të pronarit që përmban emrin, adresën, NIT (nëse ka), statusin e kapitullit 4, dhe një përshkrim të llojit të dokumentacionit, të siguruar për agjentin e mbajtjes së tatimit në burim, për çdo person që zotëron një interes borxhi, që përbën një llogari financiare ose interes të drejtpërdrejtë të kapitalit neto në entitet; **dhe**
  - Ka siguruar dokumentacionin që përcakton se çdo pronar i entitetit është një entitet i përshkruar në pjesën 1.1471-6(b), (c), (d), (e), (f) dhe/ose (g) të Rregullores pa marrë parasysh nëse pronarë të tillë janë pronarë përfitues.

**Pjesa XVII Institucion financiar i territorit**

- 31  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I është institucion financiar (por jo entitet investues) që është i përfshirë ose i organizuar sipas ligjeve të territorit në pronësi të Shteteve të Bashkuara.

**Pjesa XVIII Subjekt i liruuar i grupit jo-financiar**

- 32  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I:
- Është një kompani holding, qendër thesari ose një kompani financimi e kontrolluar nga kompani të tjera dhe në thelb të gjitha aktivitetet e subjektit janë funksione të përshkruara në pjesën 1.1471-5(e)(5)(i)(C) deri në (E) të Rregullores;
  - Është një anëtar i një grupi jo-financiar të përshkruar në pjesën 1.1471-5(e)(5)(i)(B) të Rregullores;
  - Nuk është institucion depozitues ose kujdestar (përveçse për anëtarët e grupit shumëkombësh të zgjeruar të subjektit); **dhe**
  - Nuk funksionon (ose nuk mbahet) si një fond investimesh, siç është fondi i kapitalit privat, fondi i kapitalit investues, fondi "leveraged buyout fund", ose ndonjë instrument investimi me një strategji investimi për të blerë ose financuar ndërmarrjet dhe më pas për të mbajtur interesa në ato kompani si asete kapitale për qëllime investimi.

**Pjesa XIX Kompani fillestare jo-financiare e liruuar**

- 33  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I:
- Është formuar më (ose, në rastin e një linje të re biznesi, data e rezolutës së bordit që aprovon linjën e re të biznesit) \_\_\_\_\_ (data duhet të jetë më pak se 24 muaj para datës së pagesës);
  - Akoma nuk është duke operuar një biznes dhe nuk ka histori veprimi paraprake ose është duke investuar kapital në asete me qëllim të funksionimit të një linje të re biznesi përveç asaj të një institucioni financiar ose EHJF pasiv;
  - Është duke investuar kapitalin në asete me synimin për të drejtuar një biznes tjetër përveç atë të një institucioni financiar; **dhe**
  - Nuk funksionon (ose nuk mbahet) si një fond investimesh, siç është fondi i kapitalit privat, fondi i kapitalit investues, fondi "leveraged buyout fund", ose ndonjë instrument investimi qëllimi i të cilit është për të blerë ose financuar ndërmarrjet dhe më pas të mbajnë interesa në ato kompani si asete kapitale për qëllime investimi.

**Pjesa XX Subjekt i liruuar jo financiar në likuidim ose falimentim**

- 34  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I:
- Ka paraqitur një plan të likuidimit, ka paraqitur një plan të riorganizimit ose ka paraqitur kërkesën për falimentim më \_\_\_\_\_;
  - Gjatë 5 viteve të fundit nuk ka qenë i angazhuar në biznes si institucion financiar ose ka vepruar si EHJF pasive;
  - Është në likuidim ose duke dalë nga riorganizimi ose falimentimi me qëllim për të vazhduar ose rifilluar veprimtarinë si entitet jo financiar; **dhe**
  - Ka, ose do të sigurojë, dëshmi të dokumentuara të tilla si një kërkesë falimentimi ose dokumentacion tjetër publik që mbështet pretendimin e tij nëse mbetet në falimentim ose likuidim për më shumë se 3 vjet.

**Pjesa XXI Organizatë sipas seksionit 501(c)**

35  Vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I është një organizatë sipas pjesës 501(c):

- Të cilës i është lëshuar letra e vendimit nga SHBH aktualisht në fuqi, që konkludon se kreditori është organizatë sipas pjesës 501(c) të datës \_\_\_\_\_; **ose**
- E cila ka dorëzuar një kopje të opinionit nga një avokat amerikan që vërteton se kreditori është organizatë sipas pjesës 501(c) (pavarësisht nëse kreditori është fondacion privat i huaj).

**Pjesa XXII Organizatë jo fitimprurëse**

36  Vërtetohet që subjekti i identifikuar në Pjesën I është organizatë jofitimprurëse e cila i përmbush kërkuesat në vijim.

- Subjekti është themeluar dhe funksionon në vendin e tij të rezidencës ekskluzivisht për qëllime fetare, bamirëse, shkencore, artistike, kulturore ose arsimore;
- Subjekti është i liruar nga tatimi në të ardhura në vendin e tij të rezidencës;
- Subjekti nuk ka aksionarë ose anëtarë që kanë interes pronësor ose përfitues në të ardhurat ose asetet e tij;
- As ligjet e zbatueshme të vendit të rezidencës së subjektit, as dokumentet themeluese të subjektit nuk lejojnë që të ardhurat ose asetet e subjektit të shpërndahen ose zbatohen në përfitim të një personi privat ose subjekti jo bamirës përveçse në përputhje me realizimin e aktiviteteve bamirëse të subjektit ose si pagesë e kompensimit të arsyeshëm për shërbimet e ofruara ose pagesë që përfaqëson vlerën reale të tregut të pronës të cilën e ka blerë subjekti; **dhe**
- Ligjet e zbatueshme të vendit të rezidencës së subjektit dhe dokumentet themeluese të subjektit kërkojnë që, me rastin e likuidimit ose shpërbërjes së subjektit, të gjitha asetet e tij t'i jepen një subjekti që është qeveri e huaj, pjesë përbërëse e një qeverie të huaj, subjekt i kontrolluar nga një qeveri e huaj ose organizatë tjetër që përshkruhet në këtë pjesë ose t'i kalojnë në pronësi qeverisë së vendit të rezidencës së subjektit ose një nënndarjeje politike të saj.

**Pjesa XXIII EHJF i tregtuar publikisht ose EHJF i ndërlidhur i një korporate të tregtuar publikisht**

Përzgjidhni kutinë 37a ose 37b, cilado që aplikohet.

37a  Vërtetohet që:

- Entiteti i identifikuar në Pjesën I është korporatë e huaj që nuk është institucion financiar; **dhe**
- Aksionet e kësaj korporate tregtohen rregullisht në një ose më tepër tregje të krijuara të letrave me vlerë, duke përfshirë \_\_\_\_\_ (shënoni një bursë të letrave me vlerë në të cilën aksionet tregtohen rregullisht).

b  Vërtetohet që:

- Entiteti i identifikuar në Pjesën I është korporatë e huaj që nuk është institucion financiar;
- Entiteti i identifikuar në Pjesën I është anëtar i të njëjtit grup të ndërlidhur të zgjeruar si subjekt aksionet e të cilit tregtohen rregullisht në një treg të krijuar të letrave me vlerë;
- Emri i entitetit aksionet e të cilit tregtohen rregullisht në një treg të krijuar të letrave me vlerë, është \_\_\_\_\_; **dhe**
- Emri i tregut të letrave me vlerë në të cilin letrat me vlerë tregtohen rregullisht është \_\_\_\_\_

**Pjesa XXIV EHJF i territorit të liruar**

38  Vërtetohet që:

- Entiteti i identifikuar në Pjesën I është subjekt i organizuar në një territor të SHBA-së;
- Entiteti i identifikuar në Pjesën I:
  - (i) Nuk pranon depozita në rrjedhën e zakonshme të një biznesi bankar ose të ngjashëm;
  - (ii) Nuk mban, si pjesë përbajtëse e biznesit të saj, asete financiare në llogari të të tjerëve; **ose**
  - (iii) Nuk është kompani sigurimi (ose kompani holding e një kompanie sigurimi) që lëshon ose është e detyruar të bëjë pagesa në lidhje me një llogari financiare; **dhe**
- Të gjithë pronarët e entitetit të identifikuar në Pjesën I janë banorë *bona fide* të territorit ku EHJF është organizuar ose themeluar.

**Pjesa XXV EHJF aktiv**

39  Vërtetohet që:

- Entiteti i identifikuar në Pjesën I është subjekt i huaj që nuk është institucion financiar;
- Më pak se 50% e të ardhurave bruto të këtij subjekti për vitin kalendarik paraprak janë të ardhura pasive; **dhe**
- Më pak se 50% e aseteve të mbajtura nga ky entiteti janë asete që gjenerojnë ose mbahen për gjenerimin e të ardhurave pasive (të llogaritura si mesatare e ponderuar e përqindjes së aseteve pasive të matura në baza tremujore) (shih udhëzimet për përkufizimin e të ardhurave pasive).

**Pjesa XXVI EHJF pasiv**

40a  Vërtetohet që subjekti i identifikuar në Pjesën I është subjekt i huaj që nuk është institucion financiar (por jo subjekt investues i organizuar në një territor të SHBA-së) dhe nuk e certifikon statusin e tij si EHJF e tregtuar publikisht (ose e ndërlidhur), EHJF e një territori të liruar, EHJF aktive, EHJF raportuese e drejtpërdrejtë ose EHJF raportuese e drejtpërdrejtë e sponsorizuar.

Përzgjidhni kutinë 40b ose 40c, cilado që aplikohet.

- b  Gjithashtu vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I nuk ka pronarë përbajtësorë amerikanë (ose, nëse vlen, nuk ka persona kontrollues amerikanë); **ose**
- c  Gjithashtu vërtetohet që entiteti i identifikuar në Pjesën I ka dhënë emrin, adresën dhe NIT-in e çdo pronari përbajtësorë amerikan (ose, nëse vlen, çdo personi kontrollues amerikan) të EHJF në Pjesën XXIX.

